



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2551/9 prot.

Datë 07.11.2025

V E N D I M
Nr. 1610/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 07.11.2025, shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga BOE “KUPA” shpk & “SELAMI” shpk & “STERKAJ” Shpk, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-57300-08-06-2025, me objekt “Ndërtim Rrugët Blloku 1 Frutikulturë”, me vlerë 100,115,759 (njëqind milion e njëqind e pesëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e nëntë) lekë pa Tvsh, zhvilluar më datë 29.08.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga BOE “Shëndelli” Shpk & “Mateo” SHPK, në procedurën e prokurimit sipërcituar.

Ankimues:

BOE “KUPA” shpk (përfaqësues) me NIPT K51615512C dhe adresë: Kamez Tirane Kamez, KAMEZ, Rruga Berisha, Argjjinatura me nr.pasurie 482, Çerkeze & “SELAMI” shpk & “STERKAJ” Shpk.

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Kamëz me adresë: Bulevardi “Nënë Tereza” nr.492 Kamëz Tiranë

Subjekt i interesuar: BOE “Shëndelli” Shpk (përfaqësues) me NUIS K07924803N me adresa: MALLAKASTER Fier Fier Fier, FIER, Lagjja "Kastrioti", rruga "Andon Profka", 2 kullat Fier & “Mateo” SHPK.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I 1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 07.08.2025, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-57300-08-06-2025, me objekt “*Ndërtim Rrugët Blloku I Frutikulturë*”, me vlerë 100,115,759 (njëqind milion e njëqind e pesëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e nëntë) lekë pa Tvsh, zhvilluar më datë 29.08.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.

II.2. Në datën 29.08.2025, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 11.09.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- | | |
|--|---|
| 1. BAJRAMI N. | |
| & KLAJGER KONSTRUKSION & VARAKU E | 69,164,573.50 lekë i skualifikuar |
| 2. 2 T & BE - IS SH.P.K & ERGI & FATI 2010 | 73,511,681 lekë i skualifikuar |
| 3. KUPA & SELAMI & STERKAJ | 77,168,226.5 lekë i skualifikuar |
| 4. "METEO".SH.p.k & Shendelli | 92,300,001 lekë i kualifikuar |
| 5. VALONA KONSTRUKSION | 92,325,743 lekë i skualifikuar |
| 6. ASI-2A CO | 98,913,623.25 lekë i kualifikuar |

II.4. Në datën 12.09.2025, është publikuar në SPE njoftimi i fituesit paraprak për procedurën e prokurimit objekt – ankimi, publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 51, datë 15.09.2025, ku është shpallur fitues BOE “Shëndelli” Shpk & “Mateo” Shpk.

II.5. Në datën 18.09.2025 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2025/5828, si dhe nr. 2551/2025 prot., datë 18.09.2025 e BOE “KUPA” shpk & “SELAMI” shpk & “STERKAJ” Shpk, në procedurën e prokurimit të sipërcituar. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me kundërshtimi e vendimmarrjes së autoritetit kontraktor mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga BOE “KUPA” shpk & “SELAMI” shpk & “STERKAJ” Shpk, si dhe me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga BOE “Shëndelli” Shpk & “Mateo” SHPK, i cili nuk përmbush kriteret e vendosura për kualifikim sipas kriterëve të kualifikimit të bërë nga autoriteti kontraktor, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

II.6. Bazuar në nenin 112, pika 3, të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr. 2551/1 prot., datë 19.09.2025, lidhur me arsyet e skualifikimit të ankimuesit dhe pretendimet për subjektin fitues

II.9. Me datë 23.09.2025 protokolluar me tonën me nr. 2551/2 prot., datë 23.09.2025, OE “Shëndelli” SHPK ka paraqitur në sistemin e ankesave elektronike formularin e argumentave, në cilësinë e subjektit të interesuar në kuptim të nenit 113 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar.

II.10. Me shkresën përcjellëse me nr. 8153/1 prot., datë 22.09.2025, protokolluar me tonën me nr. 2551/3 prot., datë 25.09.2025, autoriteti kontraktor, ka dërguar me shërbim postar, vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave (me nr. 8153 prot., datë 22.09.2025, Vendimi KSHA), duke e refuzuar atë.

II.11. Me shkresën me nr. 2551/4 prot., datë 14.10.2025, Komisioni i Prokurimit Publik, iu drejtua Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit, për ti kërkuar informacion për certifikimin e subjektit “Eko Geolab&Chimica” shpk.

II.12. Me shkresën me nr. 2551/5 prot., datë 14.10.2025, Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua palëve në procesin administrativ, që për shkaqe të nevojshme për verifikim, nuk është e mundur dalja me një vendim përfundimtar brenda afatit të parashikuar në LPP.

II.13. Me shkresën me nr. 44/1 prot., datë 15.10.2025, protokolluar me tonën me nr. 2551/6 prot., datë 17.10.2025, Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, ka kthyer përgjigje.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor dhe verifikimeve të kryera,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e BOE “KUPA” shpk & “SELAMI” shpk & “STERKAJ” Shpk mbi skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit me arsyen se: *“Boe Kupa shpk & Sterkaj Shpk & Selami Shpk nuk kane plotesuar piken 2.3.13 te DSTku kerkohet Operatori ekonomik duhet të kenë kontratë noteriale me një laborator testimi të betonit, i cili duhet të jetë i akredituar nga organizma kombëtar ose ndërkombëtar sipas standarteve SSHEN ISO SSH EN ISO 12350-2:2019, SSH EN ISO 12504-2:2021, SSH EN ISO 6892 - 1:2019, SSH EN 1 ISO 2390-8:2019, SSH EN 12697- 5:2018, SSH EN 1426 :2015 , kontrata me laboratorin me Eko Geolab & Chimica Shpk nuk ka te akredituar kodin SSH EN 1426 :2015”* KPP vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 7/2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.3.13 “Kapaciteti teknik” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2.3.13..Operatori ekonomik duhet të kenë kontratë noteriale me një laborator testimi të betonit, i cili duhet të jetë i akredituar nga organizma kombëtar ose ndërkombëtar sipas standarteve SSHEN ISO SSH EN ISO 12350-2:2019, SSH EN ISO 12504-2:2021, SSH EN

ISO 6892 - 1:2019, SSH EN 1 ISO 2390-8:2019, SSH EN 12697- 5:2018, SSH EN 1426 :2015.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit Nr. 8 të DST.

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se BOE “KUPA” shpk & “SELAMI” shpk & “STERKAJ” Shpk, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar:

-Akt marrëveshje (kontratë shërbimi) me nr. Rep., xxx, Nr. Rep.xxx., datë 11.08.2025, lidur midis shoqërisë “Geolab&Chimica” shpk dhe shoqëria “Kupa” shpk, me objekt kryerjen e të gjithë llojeve të testimeve të nevojshme nga ana e kompanisë “Kupa” Shpk, për të gjitha materiet që ëhstë akredituar shoqëria “Eko Geolab&Chimica” Shpk, për një periudhë 1 vjecare.

-Ekstrakt i regjistrimit tregtar shoqëria “Eko Geolab&Chimica” Shpk, për të dhënat e subjektit “shoqëri me përgjegjësi të kufizuar”.

-Certifikatë Akreditimi Nr. Regj LT106, e vlefshme deri me 05.04.2029;

III.1.3. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: *“Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.1.4. Në nenin 3 Parime të përgjithshme: *“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

III.1.5. Në nenin 77 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.1.6. Ndërsa në nenin 79, parashikohet se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. 2. Autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dorëzimin e certifikatave ose dokumenteve të ngjashme, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, veçanërisht sa i takon: a) garantimit të aksesit të personave me aftësi të kufizuara; b) efikasitetit të energjisë; c) sistemeve të menaxhimit mjedisor. 3. Në rastet kur operatori ekonomik provon se nuk mund të pajiset me një certifikatë të tillë brenda një kohe të arsyeshme për arsye që nuk varen prej tij, autoriteti ose enti kontraktor mund të pranojë dokumente të tjera, nëpërmjet të cilave mund të provohet garantimi i standardeve të kërkuara. 4. Në çdo rast, certifikatat e kërkuara duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.

III.1.7. Në nenin 40, pika 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “6. Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti

kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose c) dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

III.1.8. Në nenin 1 “Qëllimi” e ligjit Nr. 116 datë 11.09.2014 “Për Akreditimin e Organeve të Vlerësimit të Konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet: *Ky ligj përcakton rregulla për krijimin, organizimin dhe funksionimin e sistemit të akreditimit të organeve të vlerësimit të konformitetit që kryejnë aktivitete të vlerësimit të konformitetit.*

III.1.9. Në nenin 2 “Fusha e zbatimit” e ligjit Nr. 116 datë 11.09.2014 “Për Akreditimin e Organeve të Vlerësimit të Konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet: *Ky ligj zbatohet në çdo rast akreditimi, pavarësisht nëse organi i vlerësimit të konformitetit kryen aktivitete të vlerësimit të konformitetit në fushën vullnetare apo të detyrueshme dhe pavarësisht nëse vlerësimi është i detyrueshëm apo vullnetar.*

III.1.10. Në nenin 3 “Përkufizime” e ligjit Nr. 116 datë 11.09.2014 “Për Akreditimin e Organeve të Vlerësimit të Konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet: *“Akreditim” është dëshmia/certifikata e lëshuar nga organizmi kombëtar i akreditimit për organin e vlerësimit të konformitetit, që përmbush kërkesat e përcaktuara në standardet e harmonizuara dhe, sipas rastit, çdo kërkesë shtesë, përfshirë ato të vendosura në skemat përkatëse sektoriale, për kryerjen e një veprimtarie specifike të vlerësimit të konformitetit. “Organizëm kombëtar i akreditimit” është organizmi i vetëm që kryen akreditimin me autoritetin e dhënë nga ligji. 3. “Certifikatë akreditimi” është një dokument ose një tërësi dokumentesh zyrtare, që deklarojnë akreditimin për një fushë të përcaktuar. “Vlerësim konformiteti” është procesi që provon nëse janë përmbushur kërkesat e specifikuara për një produkt, proces, shërbim, sistem, person ose organ.*

“Organ i vlerësimit të konformitetit” është çdo organ që kryen veprimtari të vlerësimit të konformitetit, përfshirë kalibrimin, testimin, certifikimin dhe inspektimin.

III.1.11. Në nenin 5 “Procesi i Akreditimit” e ligjit Nr. 116 datë 11.09.2014 “Për Akreditimin e Organeve të Vlerësimit të Konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet: 1. *Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit akrediton: a) laboratorë testues, mjekësorë dhe kalibruer; b) organe certifikuese të sistemeve të me- naxhimit; c) organe certifikuese të personelit; ç) organe certifikuese të produkteve; d)organe inspektuese; dh) organe që realizojnë teste zotësie dhe krahasime ndërlaboratorike; e) organe që prodhojnë materiale referuese të certifikuar.*

III.1.12. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” ka për detyrë d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik dhe të garantojë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

III.1.13. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit të procedurës objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar që *“Operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratë noteriale me një laborator testimi të betonit, i cili duhet të jetë i akredituar nga organizma kombëtar ose ndërkombëtar sipas standarteve SSHEN ISO SSH EN ISO 12350-2:2019, SSH EN ISO 12504-2:2021, SSH EN ISO 6892 - 1:2019, SSH EN 1 ISO 2390-8:2019, SSH EN 12697-5:2018, SSH EN 1426 :2015.* Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga BOE ankimues për përmbushjen e kriterit të mësipërm, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se ky i fundit ka paraqitur dokumentacionin e përcaktuar në pikën III.1.2 të këtij vendimi.

Referuar arsyes së skualifikimit të argumentuar nga autoriteti kontraktor, në lidhje me certifikatën e akreditimit të laboratorit testues, konkretisht: certifikat Akreditimi për subjektin “Eko Geolab & Chimica” shpk, të lëshuar nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacion dhe Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, me Nr. Regjistrimi LT 106 (Laborator Testues). Në këtë dokument për Materialin / Produktin/ Matricën e testuara **“BITUM”**, është përcaktuar Standardi / Metoda e provës ASTM D5- 05, ndërsa referuar pikës 2.3.13 të DT, është kërkuar SSH EN 1426 :2015. Në lidhje me këtë arsye skualifikimi, Komisioni iu drejtua me shkresën me nr. 2551/4 prot., datë 14.10.2025, Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit, për ti kërkuar informacion për certifikimin e subjektit “Eko Geolab & Chimica” shpk, më konkretisht për *Materialin / Produktin/ Matricën e testuara “BITUM”*, është përcaktuar Standardi / Metoda e provës ASTM D5- 05. Komisioni i Prokurimit Publik, sa më sipër analizuar, gjykon, se autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, hartimi i dokumenteve të tenderit dhe zhvillimi i procedurës së prokurimit është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt - prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejte me kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit dhe hapat që duhet të ndiqen për përzgjedhjen e ofertës më të mirë, në kuptim të këtij ligji. Nisur nga pretendimet e BOE ankimues, se arsyeja e skualifikimit të cilësuar nga autoriteti kontraktor, *“kontrata me laboratorin me Eko Geolab & Chimica Shpk nuk ka të akredituar kodin SSH EN 1426 :2015”*, e dorëzuar nga ky ofertues, si dhe nga shqyrtimi dhe verifikimi i dokumenteve të tenderit të dorëzuar nga BOE ankimues në SPE, si dhe në kuadër të shqyrtimit administrativ të ankesës, në mënyrë sa më transparente dhe të drejtë, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se për sqarimin e fakteve kërkohen verifikime të posaçme pranë organeve kompetente si Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, si institucioni i vetëm publik, i cili në bazë të ligjit nr. 116 datë 11.09.2014 *“Për Akreditimin e Organeve të Vlerësimit të Konformitetit në Republikën e Shqipërisë”*. në nenin 4 të tij thuhet se *“Drejtorja e Përgjithshme e Akreditimit është i vetmi organizëm kombëtar që kryen akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit”*. Për këtë arsye, Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit, e cila me shkresën me nr. 44/1 prot., datë 15.10.2025, protokolluar me tonën me nr. 2551/6 prot., datë 17.10.2025, ka kthyer përgjigje se, *“Standardi/Metoda e provës ASTM D5-05 shërben për përcaktimin e penetrimit të biturmit. Standardi/Metoda e provës S SH EN 1426:2015 shërben për përcaktimin e penetrimit të bitumit. Midis këtyre dy standardeve nuk ka dallime thelbësore në kërkesat e tyre, procesi i testimit është i njëjtë (të dy kanë gjilpërë të përafërt, pesha 100g dhe temperaturë testimi 25 gradë. Të dy metodat marrin tre lexime për mesatarizimin dhe kohën e leximit e kanë 5 sekonda). Nga të dhënat që japin në metodikën e tyre të testimit dhe procesin e testimit mund të konkludohet që janë ekuivalente. Referuar metodës/procesit të testimit që zbatohet nga të dy standardet përkatëse, rezultatet e testimit janë të njëjta”*.

Për sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues me dokumentacionin e paraqitur, e përmbush kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në shtojcën 7/2 të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, “kriteret e veçanta të kualifikimit”, “kapaciteti teknik” pika 2.3.13, pasi *Standardi/Metoda e provës ASTM D5-05* e paraqitur nga BOE ankimues në certifikatën e akreditimit me laboratorin

testues Eko Geolab & Chimica Shpk, është ekuivalent me *Standardi/Metoda e provës S SH EN 1426:2015*, pasi nga të dhënat që japin në metodikën e tyre të testimit dhe procesin e testimit mund të konkludohet që janë ekuivalente. Referuar metodës/procesit të testimit që zbatohet nga të dy standardet përkatëse, rezultatet e testimit janë të njëjta. Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin, se për sa kohë që këto dy standarde/metoda prove janë ekuivalente dhe nxjerrin të njëjtin përfundim, dokumentacioni i paraqitur nga BOE ankimues, në procedurën e prokurimit objekt - shqyrtimi, e plotëson kërkesën e autoritetit kontraktor dhe si i tillë konsiderohet i vlefshëm, si dhe nuk përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit. Në mënyrë eksplicite ligji për prokurimin publik parashikon, se vlerësimi i ofertave duhet bërë vetëm në përputhje me kriteret e kualifikimit të parashikuara në dokumentet e procedurës përkatëse. KPP thekson, se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor, plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Akoma më tej KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues është në kushtet e përmbushjes së kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit objekt - ankimi.

Pretendimi i BOE ankimues qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e BOE “KUPA” shpk & “SELAMI” shpk & “STERKAJ” Shpk mbi skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit me arsyen se: “*Boe Kupa shpk & Sterkaj Shpk & Selami Shpk nuk kane plotesuar piken 2.3.9, pasi Anetari i Bashkimit operatorit ekonomik Sterkaj shpk nuk ka paraqitur Certifikatën mbi Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë në Trafikun Rrugor SSH ISO 39001:2012 e vlefshme/ ose ekuivalent (Mbi Sistemet e menaxhimit të shendetit dhe sigurisë të punëtorëve në punë ose ekuivalent).*” KPP vëren se,

III.2.1. Në shtojcën 7/2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.3.9 “Kapaciteti teknik” të dokumenteve të procedurës së prokurimit të modifikuara objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2.3.9 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:

d). *Certifikatën mbi Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë në Trafikun Rrugor SSH ISO 39001:2012 e vlefshme/ ose ekuivalent (Mbi Sistemet e menaxhimit të shendetit dhe sigurisë të punëtorëve në punë ose ekuivalent). Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.*

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, Operatori ekonomik do të paraqesë ISO-t në baze të zerave të punimeve që ka marrë persiper të realizojë. Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare **SSH/DIN/EN/UNI** mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të

*lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë. **Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.***

III.2.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se BOE “KUPA” shpk & “SELAMI” shpk & “STERKAJ” Shpk, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar:

-Marrëveshje bashkëpunimi me datë 28.08.2025, ndërmjet shoqërive “KUPA” shpk & “SELAMI” shpk & “STERKAJ” Shpk, ku referuar *Nenit 3 Pjesëmarrja*, Shoqëria “Kupa” Shpk duke vënë në dispozicion të gjitha mjetet e saj dhe stafin inxhiniero-teknik zotohet të kryejë të gjitha punimet, furnizimet, të cilat pasqyrohen në preventivin e zbatimit të punimeve bashkëngjitur kësaj marrëveshje. Vlera e tyre në totalin e punimeve zë 91.6% të vlerës së punimeve. Shoqëria “Selami” Shpk duke vënë në dispozicion të gjitha mjetet e saj dhe stafin inxhiniero-teknik zotohet të kryejë të gjitha punimet, furnizimet, të cilat pasqyrohen në preventivin e zbatimit të punimeve bashkëngjitur kësaj marrëveshje. Vlera e tyre në totalin e punimeve zë 6.4% të vlerës së punimeve. Shoqëria “Sterkaj” Shpk duke vënë në dispozicion të gjitha mjetet e saj dhe stafin inxhiniero-teknik zotohet të kryejë të gjitha punimet, furnizimet, të cilat pasqyrohen në preventivin e zbatimit të punimeve bashkëngjitur kësaj marrëveshje. Vlera e tyre në totalin e punimeve zë 2% të vlerës së punimeve.

-ISO 39001:2012 me nr. Certificate AQS/RTS/xxxxx për “Kupa” Shpk me datë skadence 05.08.2026;

-ISO 39001:2012 me nr. Certificate AQS/RTS/xxxxxx për “Selami” Shpk me datë skadence 26.10.2026;

III.2.3. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: *“Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.2.4. Në nenin 3 Parime të përgjithshme: *“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

III.2.5. Në nenin 77 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për*

kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.2.6. Ndërsa në nenin 79, parashikohet se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. 2. Autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dorëzimin e certifikatave ose dokumenteve të ngjashme, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, veçanërisht sa i takon: a) garantimit të aksesit të personave me aftësi të kufizuara; b) efikasitetit të energjisë; c) sistemeve të menaxhimit mjedisor. 3. Në rastet kur operatori ekonomik provon se nuk mund të pajiset me një certifikatë të tillë brenda një kohe të arsyeshme për arsye që nuk varen prej tij, autoriteti ose enti kontraktor mund të pranojë dokumente të tjera, nëpërmjet të cilave mund të provohet garantimi i standardeve të kërkuara. 4. Në çdo rast, certifikatat e kërkuara duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.

III.2.7. Në nenin 88 pika 3 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “3. Secili prej

anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.”

III.2.8. Në nenin 92 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohej, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme. 2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet. 3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji. 4. Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit”.

III.2.9. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose

kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përbushjen e specifikimeve teknike/kritereve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

III.2.10. Komisioni i Prokurimit Publik, sa më sipër analizuar, gjykon se, autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, hartimi i dokumenteve të tenderit dhe zhvillimi i procedurës së prokurimit është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejte me kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit dhe hapat që duhet të ndiqen për përzgjedhjen e ofertës më të mirë, në kuptim të këtij ligji. KPP konstaton se, duke u kthyer tek ankesa e paraqitur në lidhje me arsyen e skualifikimit të BOE “KUPA” shpk & “SELAMI” shpk & “STERKAJ” Shpk se: *“...nuk kane plotësuar piken 2.3.9, pasi Anetari i Bashkimit operatorit ekonomik Sterkaj shpk nuk ka paraqitur Certifikatën mbi Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë në Trafikun Rrugor SSH ISO 39001:2012 e vlefshme/ ose ekuivalent (Mbi Sistemet e menaxhimit të shendetit dhe sigurisë të punëtorëve në punë ose ekuivalent).”*, nga verifikimi i dokumentave të tenderit si dhe dokumentave të ngarkuara në SPE nga BOE ekonomik ankimes Komisioni konstaton, se BOE ankimes ka dorëzuar në SPE dokumentacionin e listuar në pikën III.2.2 të këtij vendimi. Referuar arsyes së skualifikimit Komisioni konstaton, se autoriteti kontraktor në pikën 2.3.9/d të shtojcës 9 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, ka përcaktuar se: *“2.3.9/d Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë: d)-Certifikatën mbi Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë në Trafikun Rrugor SSH ISO 39001:2012 e vlefshme/ ose ekuivalent (Mbi Sistemet e menaxhimit të shendetit dhe sigurisë të punëtorëve në punë ose ekuivalent). Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.*

Ligji për Prokurimin Publik (LPP) në nenin 14, pika 2 e tij ka parashikuar edhe mënyrën e paraqitjes së ofertës nga grupe operatorësh ekonomikë si një kandidat i vetëm. Nga LPP është bërë rregullimi me akt nënligjor i paraqitjes së ofertës nga një bashkim operatorësh ekonomikë dhe është pikërisht neni 88, i VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, i cili i jep mundësinë operatorëve ekonomikë

për paraqitjen e ofertës si një bashkim operatorësh ekonomikë, duke përcaktuar pjesën e punës, shërbimit ose mallit, që do të kryej secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Në pikën 3, të po këtij neni, përcaktohet edhe mënyra e përmbushjes së kriterëve nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomikë. Në rastin konkret BOE “KUPA” shpk & “SELAMI” shpk & “STERKAJ” Shpk ka dorëzuar dokumentacionin e listuar në pikën III.2.2 të këtij vendimi. Referuar kontratës së bashkëpunimit për bashkimin e përkohshëm të operatorëve ekonomik datë 28.05.2025, *Neni 3 Pjesëmarrja*, Shoqëria “Kupa” Shpk duke vënë në dispozicion të gjitha mjetet e saj dhe stafin inxhiniero-teknik zotohet të kryejë të gjitha punimet, furnizimet, të cilat pasqyrohen në preventivin e zbatimit të punimeve bashkëngjitur kësaj marrëveshje. Vlera e tyre në totalin e punimeve zë 91.6% të vlerës së punimeve. Shoqëria “Selami” Shpk duke vënë në dispozicion të gjitha mjetet e saj dhe stafin inxhiniero-teknik zotohet të kryejë të gjitha punimet, furnizimet, të cilat pasqyrohen në preventivin e zbatimit të punimeve bashkëngjitur kësaj marrëveshje. Vlera e tyre në totalin e punimeve zë 6.4% të vlerës së punimeve. *Shoqëria “Sterkaj” Shpk duke vënë në dispozicion të gjitha mjetet e saj dhe stafin inxhiniero-teknik zotohet të kryejë të gjitha punimet, furnizimet, të cilat pasqyrohen në preventivin e zbatimit të punimeve bashkëngjitur kësaj marrëveshje. Vlera e tyre në totalin e punimeve zë 2% të vlerës së punimeve.* Neni 88, pika 3 e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikon se: *“Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”*. Në rastin konkret, Komisioni konstaton se, referuar kontratës së bashkëpunimit operatori ekonomik “Sterkaj” SHPK ka marrë përsipër të kryejë vetëm 2 % të punimeve. Akoma më tej BOE në kontratën e bashkëpunimit kanë përcaktuar se do vendosin në dispozicion të gjitha mjetet e saj dhe stafin inxhiniero-teknik zotohet të kryejë të gjitha punimet, furnizimet, të cilat pasqyrohen në preventivin e zbatimit të punimeve bashkëngjitur kësaj marrëveshje. Për më tepër, në preventivin e ndarjes së punimeve sipas palëve në bashkëpunim, për zërin FV. Tabela të ndryshme rrugore D=60cm, përvec anëtarit Sterkaj shpk, ka marrë përsipër të kryejë të tillë zëri edhe anëtari tjetër i BOE, konkretisht Kupa shpk, e cila ka dorëzuar Certifikatën mbi Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë në Trafikun Rrugor SSH ISO 39001:2012 e vlefshme.

Mbështetur në përcaktimet e pikës 3 të nenit 88 të VKM ku parashikohet se: *“Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”*, në kushtet kur operatori ekonomik pjesëmarrës është një bashkim operatorësh, dhe në kushtet kur 2 operatorët e tjerë kanë dorëzuar certifikatat ISO të kërkuara nga autoriteti kontraktor, kriteri i veçantë i kualifikimit i përcaktuar në pikën 2.3.9/d të kriterëve të veçanta të kualifikimit përmbushet nga i gjithë bashkimi. Gjithashtu, KPP sqaron se, nga shqyrtimi i dokumentacionit teknik të ngarkuar në SPE nga ana e autoritetit kontraktor, konstatohet se në dokumentin Relacion teknik.pdf faqja nr. 37, autoriteti kontraktor ka bërë një përshkrim të sinjalistikës rrugore, mbi mënyrën se si do të realizohet vendosja e sinjalistikës horizontale dhe asaj vertikale. Ndërkohë, referuar

projektit teknik, nuk evidentohet asnjë planimetri e sinjalistikës. Duke iu rikthyer kërkesës së certifikatës ISO në pikën 2.3.9/d të DT, certifikata ISO 39001:2012, është një mënyrë për t’u siguruar që një organizatë ka marrë masat e nevojshme për të garantuar sigurinë e udhëtarëve, shoferëve, dhe punonjësve të tjerë të përfshirë në aktivitetet e saj që lidhen me trafikun rrugor. Pra, kur një rrugë është në ndërtim, mund të ketë masa për të menaxhuar rrugën e kalimit dhe drejtimin e trafikut, duke përdorur sinjalizim të përkohshëm, si tabela rrugore, sinjalizues të ndriçuar etj, zë të cilat nuk janë të cituar në asnjë zë të preventivit të punimeve të ndërtimit të rrugës Blloku 1 Frutikulturë. Duke shqyrtuar edhe certifikatat ISO 39001:2012 për anëtarët e tjerë të BOE, kjo certifikatë ka të bëjë me tepër me menaxhimin logjistik të personelit dhe të mjeteve, për Menaxhimin e Sigurisë në Trafikun Rrugor, kur rruga është në funksion ose në përdorim, pas kolaudimit të veprës. Akoma më tej, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, është me vend të theksojë rolin e posaçëm që ka autoriteti kontraktor, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik dhe dokumenteve të tenderit, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të bëjë verifikimet dhe monitorimet përkatëse, për t’u siguruar nëse cilësia e shërbimit është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë.

Sa më sipër pretendimi i BOE ankimues qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimet e BOE “KUPA” shpk & “SELAMI” shpk & “STERKAJ” Shpk mbi skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit me arsyen se: *“Boe Kupa shpk & Sterkaj Shpk & Selami Shpk nuk kane plotesuar piken 2.3.10, pasi nuk kane paraqitur 2 Minidumper pesha mbajtese 2 - 5 ton (MT) te pajtura me targa sipas kerkeses se AK-se. OE Kupa ka deklaruar dy minidumper por vetem njera eshte e pajisur me targa sipas plotesimeve qe ka dhene te formulari Permbledhes I vetedeklarimit. Gjithashtu dhe OE Sterkaj ka deklaruar 1 minidumper ne Formualri Permbledhes se Vetedeklarimit,po pa targa,I pajisur vetem me fature zhdoganimi.*

-nuk kane paraqitur 2 grejder (MT) te pajtura me targa sipas kerkeses se AK-se.pra mungon 1 grejder I pajisur me targa, vetem OE Kupa ka deklaruar nje grejder me targa;

-nuk kane plotesuar piken 2.3.10, pasi dy anetaret e BOE Sterkaj sh.p.k dhe Selami Sh.p.k nuk kane deklaruar se disponojne asnje kokore, jeleke, fikse zjarri dhe kuti e ndihmes se shpejte, pajisje qe nevojiten per te plotesuar perqindjen e punimeve qe kane marr persiper per te realizuar” KPP vëren se,

III.3.1. Në shtojcën 7/2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.3.10 “Kapaciteti teknik” të dokumenteve të procedurës së prokurimit të modifikuara objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2.3.10 *Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8) konkretisht:*

Nr.	Mjete/pajisje teknike	Sasia	Gjendja

10	Grejder (MT) me targa	2 copë	Në pronësi ose me qera
29	Minidumper pesha mbajtëse 2 - 5 ton (MT) me targa	2 copë	Në pronësi ose me qera

Operatori ekonomik ne vijim duhet te dispoinoje gjithashtu Mjetet dhe paisjet mbrojtëse në punë si me poshte:

- Kokore mbrojtëse 60 copë
- Jelekë 60 copë
- Fikse Zjarri 5 copë
- Tabela Sigurimi Teknik 10 copë
- Kutu Ndihmë e shpejtë 5 copë

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit Nr. 8 të DST.

a. Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) leje qarkullimi; c) çertifikate e kontrollit teknik (e vlefshme); d) siguracion mjeti (i vlefshëm); f) Leje transporti (leshuar nga pushteti vendor e vlefshme)

b. Për mjetet e deklaruar me qera duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse e Qerasë/huapërdorjes e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) leje qarkullimi; c) çertifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme) d) siguracion mjeti (i vlefshëm); f) Leje transporti (leshuar nga pushteti vendor e vlefshme). Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes. Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.

Për mjetet e deklaruar që transportojnë mallra të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme (Autobitumatrice), duhet të paraqitet çertifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet përkatëse (e vlefshme).

c. Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruar në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.

d. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për vendndodhjen e mjeteve ne pronesi ose me qera me qellim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor.

III.3.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se BOE “KUPA” shpk & “SELAMI” shpk & “STERKAJ” Shpk, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar:

-Marrëveshje bashkëpunimi me datë 28.08.2025, ndërmjet shoqërive “KUPA” shpk & “SELAMI” shpk & “STERKAJ” Shpk, ku referuar Nenit 3 Pjesëmarrja, Shoqëria “Kupa” Shpk duke vënë në dispozicion të gjitha mjetet e saj dhe stafin inxhiniero-teknik zotohet të kryejë të gjitha punimet, furnizimet, të cilat pasqyrohen në preventivin e zbatimit të punimeve bashkëngjitur kësaj marrëveshje. Vlera e tyre në totalin e punimeve zë 91.6% të vlerës së punimeve. Shoqëria “Selami” Shpk duke vënë në dispozicion të gjitha mjetet e saj dhe stafin inxhiniero-teknik zotohet të kryejë të gjitha punimet, furnizimet, të cilat

pasqyrohen në preventivin e zbatimit të punimeve bashkëngjitur kësaj marrëveshje. Vlera e tyre në totalin e punimeve zë 6.4% të vlerës së punimeve. Shoqëria “Sterkaj” Shpk duke vënë në dispozicion të gjitha mjetet e saj dhe stafin inxhiniero-teknik zotohet të kryejë të gjitha punimet, furnizimet, të cilat pasqyrohen në preventivin e zbatimit të punimeve bashkëngjitur kësaj marrëveshje. Vlera e tyre në totalin e punimeve zë 2% të vlerës së punimeve.

- Formular Përmbledhës i vetëdeklarimit nga OE “Kupa” Shpk;
- Formular Përmbledhës i vetëdeklarimit nga OE “Sterkaj” Shpk;
- Formular Përmbledhës i vetëdeklarimit nga OE “Selami” Shpk;

III.3.3. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.3.4. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se:

1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.3.5. Në nenin 21, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, thuhet shprehimisht: “1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.”

III.3.6. Në nenin 77, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohej nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohej operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Neni 92 pika 4 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet se: 23 “Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit”.

III.3.7. Neni 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

“4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës; dhe/ose

c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”.

III.3.8. Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht : “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.”

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.3.9. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se:

“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërket për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë; ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi; gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të V, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”

III.3.10. Në nenin 47 “Klasifikimi i mjeteve rrugore” të ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar parashikohet se:

1. Mjetet, sipas qëllimeve të përcaktuara në këtë Kod, klasifikohen si vijon:

- a) mjete që lëvizin me forcën e krahut;
- b) mjete të tërhequra me kafshë;
- c) mjete me pedal;
- d) slita;
- e) ciklomotori;
- f) motomjete;
- g) automjete;
- h) trolejbusë;
- i) rimorkio;
- j) makina bujqësore;
- k) makina teknologjike;
- l) mjete rrugore të veçanta.

2. Mjete me motor dhe rimorkiot e tyre, sipas shkronjave “e”, “f”, “g”, “h”, “i” “j” dhe “l”, të pikës 1, të këtij neni, klasifikohen, gjithashtu, në bazë të kategorive ndërkombëtare si më poshtë:

a) - Kategoria L1: mjete me dy rrota, cilindrata e motorit (kur flitet për motor me djegie të brendshme) të mos i kalojë 50 cm³ dhe me shpejtësi maksimale të projektuar (për çdo lloj sistemi motorik) jo më të madhe se 45 km/h, fuqia maksimale nuk është më shumë se 4 kË në

rastin e një motori elektrik;

- *Kategoria L2: mjete me tri rrota, cilindrata e motorit (kur flitet për motor me djegie të brendshme) të mos i kalojë 50 cm³ dhe me shpejtësi maksimale të projektuar (për çdo lloj sistemi motorik) jo më të madhe se 45 km/h; rendimenti maksimal neto i fuqisë nuk është më shumë se 4 kË, në rastin e motorëve të tjerë me djegie të brendshme, ose fuqia maksimale e vazhdueshme nuk është më shumë se 4 kË, në rastin e një motori elektrik;*

- *Kategoria L3: mjete me dy rrota, pa kosh, cilindrata e motorit (kur flitet për motor me djegie të brendshme) është më e madhe se 50 cm³ dhe me shpejtësi maksimale të projektuar (për çdo lloj sistemi motorik) më të madhe se 45 km/h;*

- *Kategoria L4: mjete me dy rrota, me kosh, cilindrata e motorit (kur flitet për motor me djegie të brendshme) është më e madhe se 50 cm³ dhe me shpejtësi maksimale të projektuar (për çdo lloj sistemi motorik) më të madhe se 45 km/h;*

- *Kategoria L5: mjete me tri rrota të përshtatura simetrikisht, cilindrata e motorit (kur flitet për motor me djegie të brendshme) është më e madhe se 50 cm³ dhe me shpejtësi maksimale të projektuar (për çdo lloj sistemi motorik) më të madhe se 45 km/h;*

- *Kategoria L6: mjete me katër rrota të lehta, masa e pangarkuar e të cilave nuk është më shumë se 350 kg, pa përfshirë masën e baterive në rastin e automjeteve elektrike, me shpejtësi maksimale të projektuar jo më të madhe se 45 km/h, cilindrata e motorit të mos i kalojë 50 cm³ dhe rendimenti maksimal neto i të cilëve nuk është më shumë se 4 kË, në rastin e motorëve të tjerë me djegie të brendshme, ose fuqia maksimale e vazhdueshme e të cilëve nuk është më shumë se 4 kË, në rastin e një motori elektrik;*

- *Kategoria L7: mjete me katër rrota të ndryshme nga L6, masa e pangarkuar e të cilave nuk është më shumë se 400 kg (550 kg për automjetet e synuara për transportimin e mallrave), pa përfshirë masën e baterive, në rastin e automjeteve elektrike, dhe fuqia maksimale neto e motorit e të cilave nuk është më shumë se 15 kË;*

b) - *kategoria M: mjete me motor të destinuara për transport njerëzish dhe që kanë të paktën katër rrota;*

- *kategoria M1: mjete të destinuara për transport njerëzish dhe që nuk kanë më shumë se tetë ndenjëse, përveç ndenjësës së drejtuesit të mjetit;*

- *kategoria M2: mjete të destinuara për transport njerëzish dhe që kanë më shumë se tetë ndenjëse, përveç ndenjësës së drejtuesit të mjetit dhe peshë maksimale me ngarkesë deri 5 tonë;*

- *kategoria M3: mjete të destinuara për transport njerëzish dhe që kanë më shumë se tetë ndenjëse, përveç ndenjësës së drejtuesit të mjetit dhe peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 5 tonë;*

c) - *kategoria N: mjete me motor të destinuara për transport mallrash dhe që kanë të paktën katër rrota;*

- *kategoria N1: mjete të destinuara për transport mallrash dhe që kanë peshë maksimale me ngarkesë jo më të madhe se 3,5 tonë;*

- *kategoria N2: mjete të destinuara për transport mallrash, me peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 3,5 tonë, por jo më të madhe se 12 tonë;*

- *kategoria N3: mjete të destinuara për transport mallrash, me peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 12 tonë;*

d) - *kategoria O: rimorkiot (përfshirë edhe gjysmërimorkiot);*

- kategoria O1: rimorkio me peshë maksimale me ngarkesë jo më të madhe se 0,75 tonë,
- kategoria O2: rimorkio me peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 0,75 tonë, por jo më të madhe se 3,5 tonë;
- kategoria O3: rimorkio me peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 3,5 tonë, por jo më të madhe se 10 tonë;
- kategoria O4: rimorkio me peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 10 tonë.
- dh) - Kategoria T: traktorët me rrota;
- Kategoria T1: traktorët me rrota, me shpejtësi maksimale në kushte sigurie prej jo më shumë se 40 km/h, me boshtin më të afërt te drejtuesi, që ka gjerësi minimale zinxhiri prej jo më pak se 1150 mm, me një masë të pangarkuar në rend të njëpasnjëshëm prej më shumë se 600 kg dhe me lartësi nga toka prej jo më shumë se 1 000 mm;
- Kategoria T2: traktorët me rrota, me shpejtësi maksimale në kushte sigurie prej jo më shumë se 40 km/h, me gjerësi minimale zinxhiri prej më pak se 1150 mm, e një masë të pangarkuar në rend të njëpasnjëshëm prej më shumë se 600 kg dhe me lartësi nga toka prej jo më shumë se 600 mm;
- Kategoria T3: traktorët e pajisur me rrota, me shpejtësi maksimale në kushte sigurie prej jo më shumë se 40 km/h dhe me një masë të pangarkuar në rend të njëpasnjëshëm prej jo më shumë se 600 kg;
- Kategoria T4: traktorët e pajisur me rrota për qëllime të veçanta, me shpejtësi maksimale në kushte sigurie prej jo më shumë se 40 km/h;
- Kategoria T5: traktorët e pajisur me rrota me shpejtësi maksimale në kushte sigurie prej jo më shumë se 40 km/h;
- Kategoria C: traktorët me zinxhirë të pandërprerë;
- Traktorët me zinxhirë të pandërprerë që shtyhen dhe drejtohen nga zinxhirë të pandërprerë dhe kategoritë e të cilëve, C1 deri C5, përcaktohen në analogji me kategoritë T1 deri T5.

III.3.11. Në nenin 58 “Makinat teknologjike” të ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar parashikohet se:

1. Makinat teknologjike janë makina vetëlëvizëse ose që tërhiqen, me rrota ose me zinxhirë. Këto makina janë të destinuara të operojnë mbi rrugë dhe në kantiere dhe mund të jenë të pajisura me mekanizma specialë. Këto mjete mund të lëvizin në rrugë për të kaluar nga një vend pune në tjetrin ose për të zhvendosur sende që lidhen me ciklin e punës së vetë makinës ose të kantierit, sipas kufizimeve dhe mënyrave të përcaktuara nga aktet në zbatim.
2. Sipas qëllimeve të qarkullimit rrugor, makinat teknologjike ndahen në:
 - a) makina që përdoren për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e veprave ndërtimore a të infrastrukturës rrugore ose për rivendosjen e trafikut;
 - b) makina që zhbllokojnë rrugën nga bora ose ndihmëse që shpërndajnë rërë a gjëra të këtij lloji;
 - c) motopirunët dhe elektropirunët: mjete të destinuara për lëvizjen e sendeve.
3. Makinat teknologjike vetëlëvizëse, sipas karakteristikave që kanë, mund të kenë jo më shumë se tri ndenjese për personelin e shërbimit, duke përfshirë edhe drejtuesin e tyre.
4. Për t’iu përshtatur qarkullimit rrugor, këto makina nuk duhet të jenë të afta ta kalojnë shpejtësinë 40 km/h, kur lëvizin në rrugë horizontale, kurse makinat teknologjike vetëlëvizëse

me rrota jopneumatike a me zinxhirë nuk duhet të jenë të afta ta kalojnë shpejtësinë 15 km/h, kur lëvizin në rrugë horizontale.

III.3.12. Në nenin 113 “Qarkullimi në rrugë i makinave teknologjike” të ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar parashikohet se:

- 1. Për të qarkulluar në rrugë makinat teknologjike duhen respektuar përmasat gabaritë kufitare dhe peshat kufitare të përcaktuara në nenet 61 dhe 62, kurse për normat konstruktive dhe sistemet e pajimit duhet të respektojnë dispozitat e nenit 105.*
- 2. Për të qarkulluar në rrugë makinat teknologjike duhen regjistruar në zyrat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, që i lëshojnë lejen e qarkullimit atij që vërteton se është pronari i mjetit.*
- 3. Për të qarkulluar në rrugë makinat teknologjike duhen respektuar dispozitat e neneve 98, 106, 107, 110 dhe 111. Makinat teknologjike që, për kërkesa funksionale, i tejkalojnë përmasat gabaritë kufitare dhe peshat kufitare të përcaktuara në nenet 61 dhe 62, konsiderohen makina teknologjike jashtë norme dhe për to zbatohen normat e parashikuara në nenin 103, pika 8.*
- 4. Për të qarkulluar në rrugë makinat teknologjike vetëlëvizëse dhe ato që tërhiqen, duhet të jenë të pajisura me një targë njohjeje, e cila përmban të dhënat e regjistrimit.*
- 5. Mënyrat e zbatimit të pikave 2 dhe 3, si dhe ato që kanë të bëjnë me modifikimet në emërtimin e mjeteve, përmbajtjen dhe karakteristikat e lejes së qarkullimit, janë përcaktuar me udhëzime të organeve të ministrisë përgjegjëse për transportin.*
- 6. Mënyrat për regjistrimin dhe targimin përcaktohen në akte të veçanta.*
- 7. Cilido që shkel dispozitat e këtij neni, ndëshkohet me të njëjtat sanksione të parashikuara për të njëjtat shkelje të kryera me makinat bujqësore.*

III.3.13. Në nenin 209 “Kufijtë dhe mënyrat e qarkullimit të makinave teknologjike” të VKM nr. 153, datë 07.04.2000 “Për Miratimin e Rregullores së Zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar parashikohet se:

- 1. Makinat teknologjike, për të cilat flitet në nenin 58 të Kodit Rrugor, mund të qarkullojnë në rrugë, në përputhje me rregullat e vendosura nga neni 113 i Kodit Rrugor.*
- 2. Për rastin e pikës 1, makinat teknologjike mund të qarkullojnë me ose pa pajisjet e punës, të njohura nga qendra e miratimit apo homologimit si të çmontueshme, me kusht që për çdo rast të respektohen kufijtë e përmasave dhe e peshës së verifikuar nga kjo qendër, duke përfshirë këtu vlerën e raportit minimal ndërmjet peshës ose peshave që rëndojnë mbi aksin ose akset e përparme, dhe të asaj ose atyre, që rëndojnë mbi aksin ose akset e pasme.*
- 3. Të gjitha hollësitë e përshkruara në pikën 2, duhet të jenë të hedhura në librezën e automjetit, të lëshuar nga organi përkatës.*

III.3.14. Në nenin 210 “Pajisjet e makinave teknologjike” të VKM nr. 153, datë 07.04.2000 “Për Miratimin e Rregullores së Zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar parashikohet se:

1. *Makinat teknologjike duhet të jenë të miratuara dhe të verifikuara me mjete të ndryshme ndërmjet tyre, në kushte që sistemi i punës të mos pësojë ndryshime, sipas përcaktimeve të bëra në udhëzimin e Ministrisë së Transportit.*

III.3.15. Në nenin 280 “Sinjalizimi i makinave teknologjike, jashtë norme” të VKM nr. 153, datë 07.04.2000 “Për Miratimin e Rregullores së Zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar parashikohet se:

1. *Makinat teknologjike, që për nevoja funksionale, i kalojnë përmasat e parashikuara neni 113 i Kodit Rrugor, duhet të vihen në dukje me anë të paneleve, të miratuara sipas kriterëve të përcaktuara nga ministri i Transportit, i cili përcakton rregullat, numrin dhe vendmontimin e paneleve të sipërpërmendura, si dhe sinjalizimet e tjera, të nevojshme.*

III.3.16. Në nenin 281 “Fushëpamja e makinave teknologjike” të VKM nr. 153, datë 07.04.2000 “Për Miratimin e Rregullores së Zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar parashikohet se:

1. *Fushëpamja e makinave teknologjike, për të cilën është folur në nenin 58 të Kodit Rrugor, duhet të kontrollohet sipas rregullave teknike, të përcaktuara në udhëzimin e Ministrit të Transportit me udhëzim të tij.*

III.3.17. Në nenin 282 “Regjistrimi dhe vendosja e targës së makinave teknologjike” të VKM nr. 153, datë 07.04.2000 “Për Miratimin e Rregullores së Zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar parashikohet se:

1. *Makinat, të cilat lejohen të qarkullojnë në rrugë sipas neni 113 të Kodit Rrugor, duhet të regjistrohen pranë degës së DRSHTRR-së së rrethit përkatës, që merret me nxjerrjen e lejes së qarkullimit dhe të targës së atij që deklarohet pronar i mjetit.*

2. *Pronari i makinës teknologjike duhet të shënojë, në kërkesën e regjistrimit të mjetit, të dhënat e gjendjes civile dhe adresën.*

3. *Po në këtë kërkesë, nëse është e nevojshme, duhet të shënohen të dhënat e plota të ndërmarrjes së cilës i është besuar përdorimi i makinës teknologjike. Ky detyrim nuk kërkohet për makinat teknologjike, vetëlëvizëse, të pajisura me motor me fuqi jo më të madhe se 50 kë. Po kështu, ky detyrim nuk kërkohet për makina teknologjike, si vagoneta rrëshqitëse, motokarro, rula për të shtruar, makina për mbartjen e shinave dhe të ngjashme me to, për ato të caktuara për finiturën dhe trajtimin e mbulesës së rrugës, si dhe për makinat teknologjike që tërhiqen.*

4. *Në rastin e daljes nga qarkullimi të një makine teknologjike, pronari duhet të njoftojë njërën nga degët përkatëse të DRSHTRR-së, si dhe të kthejë targën e regjistrimit dhe lejen përkatëse të qarkullimit. Zyra e mësipërme lëshon dëftesën përkatëse dhe merr masa për asgjësimin e targës, për anulimin e lejes së qarkullimit dhe ndryshimet që pasojnë, të cilat arkivohen në arkivin përkatës.*

5. Për daljen e përkohshme nga qarkullimi të makinës teknologjike, pronari i makinës teknologjike duhet të njoftojë njërën nga degët përkatëse të DRSHTRR-së, duke treguar depozituesin e mjetit në ruajtje, si dhe selinë e tij.

III.3.18. Në nenin 287 “Makina teknologjike me masë jashtë norme” të VKM nr. 153, datë 07.04.2000 “Për Miratimin e Rregullores së Zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar parashikohet se:

1. Masa që peshon mbi aksin më të ngarkuar të makinave teknologjike jashtë norme, nuk duhet të jetë më e madhe se 13 tonë; vlera më të mëdha së 13 tonë mund të lejohen me kusht që shpejtësia maksimale, e llogaritur dhe e kontrolluar me mënyrat e parashikuara nga neni 208, nuk i kalon kufijtë e mëposhtëm:

a) 25 km/orë për masa mbi 13 tonë dhe jo më të mëdha se 18 tonë;

b) 15 km/orë për masë më të madhe se 18 tonë.

2. Masat e treguara më sipër janë të lejuara edhe mbi akset e tjerë, mjaft që largësia ndërmjet tyre të jetë më e madhe se 1.20 m. Këto akse duhet të jenë të pajisura me varje elastike dhe duhet të kompensojnë ndërmjet tyre ngarkesën për disnivele reciproke prej 10 cm; maksimumi i ngarkesës nuk duhet të kalojë ± 25 për qind të peshës që ushtrohet mbi çdo aks, në kushte të bashkërrafshësisë

III.3.19. Në nenin 288 “Kontrolli i makinave teknologjike në qarkullim” të VKM nr. 153, datë 07.04.2000 “Për Miratimin e Rregullores së Zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar parashikohet se:

1. Kontrolli i makinave teknologjike të regjistruara është përcaktuar në udhëzimin e ministrit të Transportit, dhe përsëritet jo më pak se në 2 vjet, duke u nisur nga data e parë e regjistrimit të vetë makinës teknologjike.

2. Kërkesat minimale të sigurisë, të miratuara sipas udhëzimit për të cilin është folur në pikën 1 janë, për sa është e zbatueshme, për këto mjete me masë të përgjithshme të përcaktuar në shtojcën VIII të këtij kapitulli.

III.3.20. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

Në pronësi				
Lloji i Mjetit	Targa	Nr. Lejes qarkullimit	Nr. Shasisë	Të tjera
MiniDumper RACO 2000 1 cope (2940kg)				
Kokore Fikese cope				
Paisje sigurimi 				

Me qira					
Lloji i Mjetit	Targa e mjetit	Nr. Lejes qarkullimit të mjetit	Nr. Shasisë së mjetit	Nr. Kont së qerasë (noterisë)	Afati i kontratës qerasë(data e fillimit dhe mbarimit)
Grejder (mjet teknologjik me targa)					
Minidumper deri 5 ton (mjet teknologjik)					

-Formular Përmbledhës i vetëdeklarimit nga OE “Sterkaj” Shpk;

Në pronësi				
Lloji i Mjetit	Targa	Nr. Lejes qarkullimit	Nr. Shasisë	Të tjera
Minidumper 1 cope				
GREJDER				

-Formular Përmbledhës i vetëdeklarimit nga OE “Selami” Shpk;

Në pronësi				
Lloji i Mjetit	Targa	Nr. Lejes qarkullimit	Nr. Shasisë	Të tjera
Greder Caterpillar				

III.3.21. Referuar sa më sipër KPP gjykon, se secili anëtar i BOE në lidhje me deklarimin e të dhënave të mjeteve, nga verifikimi i shtojcës 8 “*Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit*” rezulton se, e ka përmbushur kriterin e veçantë të kualifikimit të parashikuar në pikën 2.3.10. Për sa i përket mjeteve të pretenduara si minidampur dhe grejder, që nuk disponojnë dokumentacionin të rregullt sipas kërkesave të autoritetit mkontraktor, secili anëtar i BOE ka deklaruar duke plotësuar të gjitha fushat e kërkuara në tabelën e mjeteve me qera/pronësi, tek seksioni respektiv të Formularit përmbledhës të vetëdeklarimit të paraqitur. KPP gjykon, se nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga BOE ankimues në SPE rezulton, se për të gjitha mjetet e deklarauara në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ka deklaruar se

disponon me kontratë qeraje/ pronësi të gjitha mjetet, duke përmbyshur numrin total të kërkuar të tyre, dhe secili mjet është me dokumentacion shoqërues me leje qarkullimi, certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (te vlefshme), certifikatene pronësisë së mjetit, foton e mjetit. Për sa i përket mjeteve të pretenduara (minidamper dy copë dhe Grejder dy copë) që nuk përmbyshin dokumentacionin teknik të kërkuar, pasi nuk janë mjete të treguara referuar kërkesave të hartuara nga autoriteti kontraktor në pikën 2.3.10 të DT, Komisioni gjykon se argumentimi i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave nuk qëndron, pasi ka interpretuar gabim përcaktimet e nenit 58, të ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ku në këtë dispozitë përcaktohet se cilat mjete klasifikohen si “mjete teknologjike” dhe fakti që këto mjete janë me goma jo domosdoshmërisht përcakton dhe detyrimin që të pajisen me targa, ndërkohë që në interpretim të përcaktimeve të nenit 113 të ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, të gjitha kategorite e mjeteve (të përcaktuara në nenin 47 të ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar) përfshirë dhe mjetet teknologjike në momentin kur qarkullojnë në rrugë duhet të jenë të pajisur me targa, ndërsa në rastin kur lëvizin vetëm në kantier atëherë nuk kanë detyrim që të pajisen me targa. Edhe neni 282 “Regjistrimi dhe vendosja e targës së makinave teknologjike” të VKM nr. 153, datë 07.04.2000 “Për Miratimin e Rregullores së Zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar parashikon se “Makinat, të cilat lejohen të qarkullojnë në rrugë sipas nenit 113 të Kodit Rrugor, duhet të regjistrohen pranë degës së DRSHTRR-së së rrethit përkatës, që merret me nxjerrjen e lejes së qarkullimit dhe të targës së atij që deklarohet pronar i mjetit”. Përsa kohë që legjislacioni posacëm nuk e parashikon të detyrueshme rregjistrimin dhe targimin e mjeteve teknologjike, atëherë edhe pretendimi i autoritetit kontraktor për këtë arsye skualifikimi nuk është e saktë, pasi në nenin 282 të Vendimit të sipërcituar në pikën 3 të tij parashikon se ky detyrim nuk kërkohej për makinat teknologjike, vetëlëvizëse, të pajisura me motor me fuqi jo më të madhe se 50 kw. Po kështu, ky detyrim nuk kërkohej për makina teknologjike, si vagoneta rrëshqitëse, motokarro, rula për të shtruar, makina për mbartjen e shinave dhe të ngjashme me to, për ato të caktuara për finiturën dhe trajtimin e mbulesës së rrugës, si dhe për makinat teknologjike që tërhiqen. Nga kjo dispozitë qartësisht është e kuptueshme se rregjistrimi i mjeteve teknologjike është i detyrueshëm vetëm në rastet se këto mjete do të qarkullojnë në rrugë, në rast se këto mjete do të qarkullojnë në kantier nuk është e nevojshme, gjithashtu ky nen përbën edhe raste përjashtimore ashtu sikurse mësipërcituam. Komisioni sqaron se në kushtet kur Komisioni i Vlerësimit të Ofertave edhe Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës ka patur paqartësi, duhet t’i kërkonte sqarime ofertuesit, apo organeve të caktuara me ligj të posacëm pasi në kushtet kur nuk është i qartë, nuk mund të referojë një arsye skualifikimi të tillë. KPP gjykon, se me dokumentacionin e paraqitur BOE ankimes për këtë fazë, dëshmon se disponon mjetet e kërkuara sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.

-Ndërsa në lidhje me arsyen e skualifikimit se anëtarët e BOE, konkretisht “Selami” Shpk & “Sterkaj” Shpk, nuk disponojnë asnjë kokore, jelek, fiske zjarri dhe kuti e ndihmës së shpejtë, KPP sqaron se, ligji për Prokurimin Publik (LPP) në nenin 14, pika 2 e tij ka parashikuar edhe mënyrën e paraqitjes së ofertës nga grupe operatorësh ekonomikë si një kandidat i vetëm. Nga LPP është bërë rregullimi me akt nënligjor i paraqitjes së ofertës nga një bashkim

operatorësh ekonomikë dhe është pikërisht neni 88, i VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, i cili i jep mundësinë operatorëve ekonomikë për paraqitjen e ofertës si një bashkim operatorësh ekonomikë, duke përcaktuar pjesën e punës, shërbimit ose mallit, që do të kryej secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Në pikën 3, të po këtij neni, përcaktohet edhe mënyra e përmbushjes së kriterëve nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomikë. Në rastin konkret BOE “KUPA” shpk & “SELAMI” shpk & “STERKAJ” Shpk ka dorëzuar dokumentacionin e listuar në pikën III.3.2 të këtij vendimi. Referuar kontratës së bashkëpunimit për bashkimin e përkohshëm të operatorëve ekonomik datë 28.05.2025, *Nenit 3 Pjesëmarrja*, Shoqëria “Kupa” Shpk duke vënë në dispozicion të gjitha mjetet e saj dhe stafin inxhiniero-teknik zotohet të kryejë të gjitha punimet, furnizimet, të cilat pasqyrohen në preventivin e zbatimit të punimeve bashkëngjitur kësaj marrëveshje. Vlera e tyre në totalin e punimeve zë 91.6% të vlerës së punimeve. Shoqëria “Selami” Shpk duke vënë në dispozicion të gjitha mjetet e saj dhe stafin inxhiniero-teknik zotohet të kryejë të gjitha punimet, furnizimet, të cilat pasqyrohen në preventivin e zbatimit të punimeve bashkëngjitur kësaj marrëveshje. Vlera e tyre në totalin e punimeve zë 6.4% të vlerës së punimeve. Shoqëria “Sterkaj” Shpk duke vënë në dispozicion të gjitha mjetet e saj dhe stafin inxhiniero-teknik zotohet të kryejë të gjitha punimet, furnizimet, të cilat pasqyrohen në preventivin e zbatimit të punimeve bashkëngjitur kësaj marrëveshje. Vlera e tyre në totalin e punimeve zë 2% të vlerës së punimeve. Neni 88, pika 3 e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikon se: *“Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”*. Në rastin konkret, Komisioni konstaton se, referuar kontratës së bashkëpunimit operatori ekonomik “Sterkaj” SHPK ka marrë përsipër të kryejë vetëm 2 % të punimeve dhe shoqëria “Selami 6.4 % të punimeve. Akoma më tej BOE në kontratën e bashkëpunimit kanë përcaktuar se do vendosin në dispozicion të gjitha mjetet e saj dhe stafin inxhiniero-teknik zotohet të kryejë të gjitha punimet, furnizimet, të cilat pasqyrohen në preventivin e zbatimit të punimeve bashkëngjitur kësaj marrëveshje. Për më tepër, në preventivin e ndarjes së punimeve sipas palëve në bashkëpunim, për zërat e punimeve, përvec anëtarit Sterkaj shpk dhe Selami Shpk, ka marrë përsipër të kryejë të tilla zëra edhe anëtari tjetër i BOE, konkretisht Kupa shpk, i cili ka dorëzuar kokore, jelek, fiske zjarri dhe kuti e ndihmës së shpejtë, në përmbushje të këtij kriteri 2.3.10.

Mbështetur në përcaktimet e pikës 3 të nenit 88 të VKM ku parashikohet se: *“Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”*, në kushtet kur operatori ekonomik pjesëmarrës është një bashkim operatorësh, dhe në kushtet kur 2 operatorët e tjerë kanë marrë përsipër zëra punimesh, të cilat do të realizohen edhe nga anëtari i tretë, kriteri i veçantë i kualifikimit i përcaktuar në pikën 2.3.10 të kriterëve të veçanta të kualifikimit përmbushet nga i gjithë bashkimi.

Për më tepër, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se përfituesi i drejtpërdrejtë i objektit të prokurimit është vetë autoriteti kontraktor dhe si i tillë ai ka një pozitë të veçantë dhe është përgjegjës për ndjekjen dhe monitorimin e zbatimit të kontratës sipas legjislacionit në fuqi, kjo bazuar në nenin 124 të LPP-së ku përcaktohet se: *“1. Autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të ndjekë zbatimin e kontratës sipas kushteve në bazë të të cilave është nënshkruar, për të garantuar se ajo zbatohet në kohën, cilësinë dhe vlerën e përcaktuar, në përputhje me kushtet e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe me legjislacionin në fuqi. 2. Për monitorimin e zbatimit të kontratës, autoriteti ose enti kontraktor, nisur nga natyra e objektit të kontratës dhe kohëzgjatja e zbatimit të saj, harton planin e zbatimit të kontratës, duke përfshirë në veçanti çështjet organizative, afatet, çështjet ekonomike e teknike të kontratës së nënshkruar, në përputhje me çdo akt tjetër ligjor. 3. Planin e zbatimit të kontratës duhet të nënshkruhet nga autoriteti ose enti kontraktor dhe operatori ekonomik brenda 7 ditëve nga nënshkrimi i kontratës dhe në çdo rast para fillimit të zbatimit të saj. 4. Çdo modifikim i kontratës në përputhje me nenin 127 të këtij ligji, pasqyrohet në planin e zbatimit. 5. Autoriteti ose enti kontraktor, në përputhje me planin, ndjek zbatimin e kontratës, administron dokumentacionin e monitorimit dhe harton raportet e monitorimit. 6. Rregulla të hollësishme për monitorimin e zbatimit të kontratave, sipas tipologjive të tyre, përcaktohen nga rregullat e prokurimit publik. Autoriteti kontraktor duhet të kryejë pagesat në favor të operatorëve ekonomikë, në përputhje me parashikimet e legjislacionit të fushës në fuqi.”* Pra është autoriteti kontraktor si organi me interes dhe përgjegjësi për realizimin me sukses të kontratës, është pikërisht ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës për t’u siguruar nëse cilësia e punëve të kërkuara është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë.

Për sa më sipër pretendimi i BOE ankimes qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimet e BOE “KUPA” shpk & “SELAMI” shpk & “STERKAJ” Shpk mbi skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit me arsyen se: *“Boe Kupa shpk & Sterkaj Shpk & Selami Shpk nuk kane plotësuar piken 2.3.13, pasi ne verifikimin e dokumentave te ngarkuar ne SPE nuk rezulton te kete ngarkuar kataloget per produktin :HEKUR”* KPP vëren se,

III.4.1. Në shtojcën 7/2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.3.13 “Kapaciteti teknik” të dokumenteve të procedurës së prokurimit të modifikuar objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2.3.13 Operatori Ekonomik per materialet e meposhtme duhet te paraqesi:

- *Materialet tuba të brinjezuar Ø 315mm (**tubo plastike**) certifikate me ISO 9001, kataloge si dhe leje mjedisore Kodi III.1.B “ per riciklim materiali plastik”.*
- *Bordura betoni 15x25 cm te paraqitet kataloget perkates dhe ISO 9001/ekuivalente per cilesine*
- *Hekur te paraqitet kataloget perkates dhe ISO 9001/ekuivalente per cilesinë.*
- *Tuba korregato duhet te paraqese katalogun/et ose skedat teknike të prodhuesit/ve, ku të specifikohen materialet që do të ofrohen si dhe te paraqiten certifikatë/deklaratë*

konfirmiteti CE, certifikatat e cilesise ose raportet e testimi nga laboratorë të akredituar, me qëllim përmbushjen e standarteve të kërkuara ne Specifikimet teknike.

III.4.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se BOE “KUPA” shpk & “SELAMI” shpk & “STERKAJ” Shpk, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar:

- Kontratë furnizimi ndërmjet furnizuesit shoqëria “Shijaku” Shpk dhe shoqërisë “Kupa” Shpk;
- Autorizim distributori nga shoqëria “Shijaku” Shpk;
- Kontratë furnizimi ndërmjet shoqërisë “Shijaku” Shpk dhe “Kurum International”sha;
- Autorizim prodhuesi nga “Kurum International”sha për shoqërinë “Shijaku” Shpk;
- ISO 9001:2015 të shoqërisë “Kurum International”sha;
- ISO 14001:2015 të shoqërisë “Kurum International”sha;
- ISO 45001:2018 të shoqërisë “Kurum International”sha;
- Test raporti e shoqërisë KURUM INTERNATIONAL SHA për hekurin sipas standardit EN 10080 (ku evidentohet, diametri, informacioni i ngrohjes, përbëria kimike, rezultatet e provës mekanike);

III.4.4. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: *Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efijencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.4.5. Në nenin 3 Parime të përgjithshme: *“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

III.4.6. Në nenin 36 “Specifikimet teknike” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: *“1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet. Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse*

ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi. 2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. 3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar: a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën; b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve; c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale; ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. 4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”. 5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente. 6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

III.4.7. Në nenin 40 pika 6 gjerat b) dhe c) ,“Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të

prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

b). fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose

c). dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

III.4.8. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.4.9. Referuar kriterit në pikën 2.3.13 të DT, autoriteti kontraktor ka kërkuar që “*Hekur te paraqitet kataloget perkates dhe ISO 9001/ekuivalente per cilësinë*”.

Nga verifikimi i dokumentacionit të ngarkuar në SPE nga BOE ankimues, në përmbushje të kriterit të sipërcituar ka dorëzuar *Autorizim distributori nga shoqëria “Shijaku” SHPK; Autorizim prodhuesi KURUM INTERNATIONAL SHA e cila është prodhuese e hekurit, autorizon shoqërinë “Shijak” SHPK që të tregojë hekur të prodhuar nga KURUM INTERNATIONAL SHA; ISO 9001:2015 e shoqërisë KURUM INTERNATIONAL SHA; Test raporti e shoqërisë KURUM INTERNATIONAL SHA për hekurin sipas standardit EN 10080 (ku evidentohet, diametri Ø-8mm, Ø-12mm, Ø14mm, Ø16mm, Ø20mm, Ø-25mm, informacioni i ngrohjes, përbërja kimike, rezultatet e provës mekanike)*. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ngarkuar në SPE , DT, relacioni teknik, specifikimet teknike, preventivi dhe projekt zbatimi nga ana autoritetit kontraktor, KPP vëren se, është kërkuar f.v. hekur betoni i zakonshëm Ø>10mm, të cilët duhet të jenë në përputhje me masat dhe gjatësitë sipas projekt zbatimit kjo referuar asaj që është përshkruar tek specifikimet teknike kapitulli 5

betonet, fraksion 5.14 Hekur armimi, por autoriteti nuk ka kërkuar specifikime teknike të veçanta në lidhje me këtë material, me qëllim që të bëjë krahasueshmërinë midis katalogut të produktit të hekurit për të vërtetuar pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. Referuar arsyes së skualifikimit të argumentuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave me arsyetimin se, nuk ka deklaruar kataloget e produktit sic kerkohet ne DST, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton, se BOE ankimues, në përmbushje të kriterit të mësipërm pika 2.3.13, ka dorëzuar test raporte nga i cili dalin të dhënat mbi specifikimet teknike të materialit hekur. Nga krahasimi i të dhënave që dalin nga test raporti i dorëzuar nga BOE ankimues, me të dhënta që kërkohej nga autoriteti kontraktor, konstatohet se përmbush kërkesën e autoritetit kontraktor për f.v.hekur betoni i zakonshëm $\Theta > 10\text{mm}$. Komisioni vlerëson se qëllimi i autoritetit kontraktor lidhur me paraqitjen e katalogut të materialit fv hekur, është që operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: fotografitë apo katalogët teknikë; dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. Akoma më tej, Komisioni gjykon se, në kushtet kur vetë autoriteti kontraktor nuk ka hartuar specifikime teknike të mirëfillta mbi materialin hekur por vetëm një përshkrim narrativ të përgjithshëm, ka patur në dispozicion momentin e tij procedural, për të kryer verifikime mbi skedën teknike/test raport të paraqitura nga ankimuesi me qëllim përmbushjen e kriterit të kërkuar. Pra, në përfundim të analizës së bërë më sipër, KPP gjykon se BOE ankimues, me dokumentacionin e paraqitur në SPE përmbush kriterin e vendosur në dokumentet e tenderit.

Rrjedhimisht pretendimi i BOE ankimues qëndron.

III.5. Lidhur me pretendimet e BOE “KUPA” shpk & “SELAMI” shpk & “STERKAJ” Shpk mbi bashkimin e operatorëve ekonomikë fitues “Shëndelli” Shpk & “Mateo” SHPK, i cili nuk përmbush kriteret e vendosura për kualifikim sipas kriterëve të kualifikimit të bërë nga autoriteti kontraktor, në procedurën e prokurimit të sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, BOE ankimues ka ofertuar me vlerë më të ulët kundrejt operatorëve për të cilët paraqet pretendime për skualifikim, duke mos pasur një interes të ligjshëm të ankohet për operatorët e renditur sipër tij, referuar vlerës ekonomike.

Sa më sipër, pretendimet e “KUPA” shpk & “SELAMI” shpk & “STERKAJ” Shpk, mbi ofertën e BOE “Shëndelli” Shpk & “Mateo” SHPK., nuk do të merren në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave

Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e BOE “KUPA” shpk & “SELAMI” shpk & “STERKAJ” Shpk, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-57300-08-06-2025, me objekt “Ndërtim Rrugët Blloku 1 Frutikulturë”, me vlerë 100,115,759 (njëqind milion e njëqind e pesëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e nëntë) lekë pa Tvsh, zhvilluar më datë 29.08.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.
 2. Autoriteti kontraktues të kryejë rivlerësimin e procedurës së mësipërme në zbatim të konstatimeve të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik në këtë vendim.
 3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga BOE “KUPA” shpk & “SELAMI” shpk & “STERKAJ” Shpk.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

